



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:086670

Datë: 11.03.2025

Numri i dokumentit: 06971548

AA.nr.83/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtar, e me bashkëpunëtoren profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, H.A, Komuna e Klinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Xh.K dhe I.N, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyrtari Y.F, me palën e interesuar, H.B, Komuna e Klinës, për shkak të anulimit të vendimit, përkitazi me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1003/2021, të datës 04.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.03.2025, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, H.A, Komuna e Klinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1003/2021, i datës 04.11.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1003/2021, të datës 04.11.2024, është vendosur, *“I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditësit H.A, Komuna e Klinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat I.N nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të “anulohet vendimi me nr. A.nr.224/2021 i datës 20.04.2019 i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, si i kundërligjshëm”. II. Mbetet në fuqi vendimi i kësaj gjykate A.nr.1003/2021 i datës 18.06.2021 për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit A.nr.224/2021 i datës 20.04.202 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale”*.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditësi, përmes përfaqësuesve të tij të autorizuar Xh.K dhe I.N, avokatë nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar A.nr.224/2021 i datës 20.04.2019, i padituri Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të gjykatës të shkallës së parë A.nr.886/2019 i datës 15.03.2021, në pikën I të vendimit ka vendosur të aprovohet si e bazuar ankesa me nr.Anr.14/2019 të datës 15.01.2019 të parashtruar nga ankuesi H.B, në pikën II të vendimit ka shfuqizuar vendimin e Komisionit të Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës të datës 21.12.2018 me nr.02 nr.112-8046/2016 dhe ka anuluar procedurën e rekrutimit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit me nr. Reference JP00034247, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, në pikën III të vendimit është obliguar Kryetari i Komunës së Klinës të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, ndërsa në pikën IV të vendimit është vendosur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e kontestuar, përmes të autorizuarve të tij ka ushtruar padi me datë 06.05.2021, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i kontestuar i KPMSHC-së A.nr.224/21 i datës 20.04.2019, si i kundërligjshëm, dhe të mbetet në fuqi vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, me arsyetim se “Gjykata fillimisht konstaton se duke pasur parasysh faktin se në rastin konkret vendimi i kontestuar i nxjerr nga i padituri A.nr.224/2021 i datës 20.04.2019, është nxjerr në procedurë administrativ sipas ankesës së ankuesit H.B, si dhe dispozitën ligjore të nenit 21 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.03/L-202 ku parashihet se “Pozitën e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t’i sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë”, me aktvendimin e datës 05.03.2024, e ka detyruar palën e interesuar që ti paraqes gjykatës përgjigje në padi si dhe ti bashkëngjisë shkresat e lëndës, mirëpo i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në padi e as nuk ka dorëzuar shkresa që kanë të bëjnë me këtë çështje juridike, e as nuk ka prezantuar në seancë të shqyrtimit kryesor. Nga provat shkresore të administruara, por edhe pohimet e palëve ndërgjyqëse gjykatës i rezultuan të jenë disa fakte të pa kontestuara. Ndër to se pas marrjes së miratimit nga Ministria e Administratës Publike, Komuna e Klinës me datë 28.09.2019, ka publikuar konkursin për plotësimin e vendit të punës Sekretar në SHFM “Ali Krasniqi”, me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit. Nuk është kontestuese as që për këtë pozitë përveç paditësit kishin aplikuar edhe tre kandidatë të tjerë respektivisht; L.G, H.B dhe L.M, ku si kandidatë të cilët ishin vlerësuar se kishin plotësuar për t’iu nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë ishin paditësi, L.G dhe H.B. Nuk ishte po ashtu kontestues se këtu paditësi pas publikimit të rezultateve të testimit me shkrim dhe me gojë me datë 05.11.2018, ishte rekomanduar nga komisioni përzgjedhës për vendin e punës Sekretar në SHFM “Ali Krasniqi”. Nuk ishte kontestues as fakti që kundër kandidatët e paditësit L.G dhe H.B, të pa kënaqur me publikimin e rezultateve për vendin e punës Sekretar në SHFM “Ali Krasniqi” kishin paraqitur ankesë në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës, ankesa këto të cilin ishin refuzuar me vendimet e këtij organi 02.nr.112-

7963/2018 të datës 17.12.2018 dhe me 02.nr.116-2638/2018 të datës 23.04.2018. Gjithashtu nuk ishte kontestues as fakti që i pa kënaqur me vendimin e KZKA të Komunës së Klinës, ankuesi H.B me datë 15.01.2019 ka paraqitur ankesë në KPMSHCK, e për të cilën ankesë ky organ duke vepruar në rivendosje sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.886/2019 të datës 15.03.2021, ka nxjerr vendim e kontestuar me nr.A.nr/224/2021 të datës 20.04.2019. Për më tepër kontestues nuk ishte as fakti që paditësit me datë 02.06.2020 nga Komuna e Klinës i është lëshuar akt emërimi me nr.112-11027/20, për pozitën Sekretar në SHFM “Ali Krasniqi dhe në SHFMU “Dëshmorët e Kombit, me koeficient 6.3, me datë të fillimit 01.06.2020, me kohëzgjatje pa afat. Kontestuese ndërmjet palëve, ishte nëse në rastin konkret organi i paditur me vendimin e kontestuar kur ka aprovuar ankesën e parashtruar nga ankuesi H.B me nr.A.nr.14/2019 të datës 15.01.2019, ka shfuqizuar vendimin e Komisionit të Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës të datës 21.12.2018 me nr.02 nr.112-8046/2016 dhe ka anuluar procedurën e rekrutimit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit me nr.refrence JP00034247, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, duke obliguar Kryetarin e Komunës së Klinës të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, ka zbatuar në mënyrë të drejt dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe të Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjet së Kontesteve dhe Ankesave, respektivisht nëse ky vendim është nxjerr në respektim të dispozitave të procedurës administrative dhe nëse i njëjti është vendim i ligjshëm dhe i drejt, për çka palët ndërgjyqëse kishin pikëpamje të ndryshme. Nga vendimi i kontestuar A.nr.224/2021 i datës 20.04.2019, gjykata gjeti se organi i paditur, duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.886/2019 i datës 15.03.2021, në dispozitivin I të vendimit të këtij vendimi ka vendosur të aprovohet si e bazuar ankesa me nr.Anr.14/2019 të datës 15.01.2019 e parashtruar nga ankuesi H.B, në pikën dy të dispozitivit të vendimit ka shfuqizuar vendimin e Komisionit të Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës të datës 21.12.2018 me nr.02 nr.112-8046/2016 dhe ka anuluar procedurën e rekrutimit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit me nr.refrence JP00034247, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, në dispozitivin III të vendimit është obliguar Kryetari i Komunës së Klinës të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në pikën IV të dispozitivit është vendosur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim. Në arsyetimin e këtij vendimi në mes tjerash është theksuar se KZKA me rastin e nxjerrjes së vendimit 02 nr.112-8046/2018 të datës 21.12.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike. Sipas të paditurit, meqenëse është konstatuar se pretendimi i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën e shpallur në konkursin e datës 2809.2018 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 par.1, është i bazuar, pasi që kandidatja L.G e cila është përfshirë në listën e shkurt nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, përderisa nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka aprovuar ankesën e ankuesit H.B ndërsa ka anuluar procedurën e rekrutimit për konkursin e lartcekur. Në nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 si ligj i aplikueshëm në rastin konkret është përcaktuar se “1. Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”. Në vazhdim në nenin 18.1 të këtij ligji është paraparë “1. Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t’u ankuar në

fund të procedurës”. Në nenin 19.1 dhe 19.2 të ligjit të njëjtë thuhet “1. Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkresë të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil. 2. Nëpunësit civilë në pozitat e karrierës pranoen në punë pa afat. Nëpunësit civilë në pozita të jo karrierës pranoen në punë me afat të caktuar”. Në nenin 19 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil është paraparë se “Shqyrtimi i aplikacioneve është faza e parë e përzgjedhjes në procesin e rekrutimit. Qëllimi i shqyrtimit është përgatitja e një liste të shkurtër të kandidatëve të kualifikuar për procedim të mëtejshëm pas vlerësimit të profilit, meritave dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat e përcaktuara për pozitën përkatëse”. Në nenin 28 par.1 të kësaj rregullore është përcaktuar “Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2 përvoja e punës; 1.3 shkathtësia dhe aftësitë; 1.4 elementet tjera të meritës”. Kurse në nenin 29 të kësaj rregullore është përcaktuar se “1. KPSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtë prej së paku prej tre kandidatëve. Nëse paneli nuk mund të identifikoj së paku tre kandidatë adekuatë për përfshirjen në listën e shkurtër, pozita duhet të ri shpallet. 2. Pas ri shpalljes së pozitës, KPSHC bën përzgjedhjen edhe nëse ka më pak se tre kandidatë për listë të shkurtë”. Nga një gjendje e tillë e çështjes, gjykata ka pranuar konkluzionet e të paditurit KPMSHCK të paraqitura në vendimin e kontestuar, me të cilin është aprovuar si e bazuar ankesa e parashtruar nga ankuesi H.B me nr.A.nr.14/2019 të datës 15.01.2019, është shfuqizuar vendimin e Komisionit të Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës të datës 21.12.2018 me nr.02 nr.112-8046/2016 , është anuluar procedurën e rekrutimit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit me nr.refrence JP00034247, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë, dhe është obliguar Kryetari i Komunës së Klinës të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, si të ligjshme dhe të drejta. Gjykata e vlerëson si të drejtë qëndrimin juridik të organit të paditur të paraqitur në vendimin e kontestuar sipas të cilit rezulton se KZKA i Komunës së Klinës me rastin e nxjerrjes së vendimit 02 nr.112-8046/2018 të datës 21.12.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike dhe se meqenëse është konstatuar se pretendimi i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën e shpallur në konkursin e datës 28.09.2018 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 par.1, është i bazuar, pasi që kandidatja L.G e cila është përfshirë në listën e shkurt nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, përderisa nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka aprovuar ankesën e ankuesit H.B ndërsa ka anuluar procedurën e rekrutimit për konkursin e lartcekur. Në këtë drejtim gjykata thekson se me dispozitën e nenit 29 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil shprehimisht është përcaktuar se “1. KPSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtë prej së paku prej tre kandidatëve. Nëse paneli nuk mund të identifikoj së paku tre kandidatë adekuatë për përfshirjen në listën e shkurtër, pozita duhet të ri shpallet. 2. Pas ri shpalljes së pozitës, KPSHC bën përzgjedhjen edhe nëse ka më pak se tre kandidatë për listë të shkurtë”. Prandaj nisur nga ky përcaktim ligjor dhe fakti që kandidatja L.G e cila kishte aplikuar në konkurs dhe ishte përzgjedhur në listën e shkurtë së bashku me paditësin dhe kandidatin H.B, është konstatuar që e njëjta nuk e kishte përvojën e punës prej 2 viteve të kërkuar me konkurs, pasi që e ajo kishte diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës me datë 02.12.2016, ndërsa sipas akt emërimit të datës 01.02.2017 ka qenë e angazhuar si praktikante vullnetare në Gjykatën Themelore në Pejë, kurse e njëjta ka aplikuar në konkursin e datës 28.09.2018, e që i bie se ka pasur 1 vit përvojë pune pas diplomimit, gjykata vlerëson se janë shkelur dispozitat e procedurës administrative, përkatësisht ato nga neni 28 dhe 29 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me rastin e

përzgjedhjes së këtu paditësit për vendin e punës Sekretar në SHFMU "Ali Krasniqi" dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit. Kjo për shkak se, bazuar në dispozitën e nenit 29.1 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, KPSHC fillimisht është dashur të përgatisë listën e ngushtë prej tre kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pozitën e shpallur që ti nënshtrohen procedurës së testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, kurse në rastin konkret kur Komisioni Përzgjedhës i Komunës së Klinës e ka përgatitur këtë listë, duke e bërë pjesë të listës edhe kandidaten L.G e cila nuk e ka pasur përvojën e punës të kërkuar me konkurs, ka bërë shkelje të kësaj dispozite kur e ka zhvilluar deri në fund procedurën e rekrutimit duke rekomanduar si kandidatë fitues paditësin, pasi që pa kandidaten L.G e cila nuk i ka plotësuar kriteret me konkurs, konkursi do të duhej të anulohet dhe të ri shpallej konkurs i ri, sepse për pozitën e lartcekur si kandidatë në listën e ngushtë do të ishin vetëm paditësi dhe kandidati tjetër H.B, e nëse tek pas ri shpalljes së konkursit nuk do të kishte tre kandidatë, atëherë përzgjedhja e tyre në listën e ngushtë do të mund të bëhej në vështrim gjithnjë të nenit 29.2 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil edhe nëse kishte për të pasur më pak se tre kandidatë. Gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit për shkelje të dispozitave ligjore nga ana e organit të paditur, respektivisht të dispozitat ligjore të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 18.1 të këtij ligji, sepse gjykata vlerëson se ashtu siç ka konstatuar me të drejtë organi i paditur në vendimin e kontestuar bazuar në nenin 11.1 dhe 18.1 të këtij ligji është paraparë se "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës". Në këtë aspekt gjykata thekson se fakti që paditësi është përzgjedhur për pozitën e punës Sekretar në SHFMU "Ali Krasniqi" dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit dhe i njëjti i ka plotësuar kriteret me konkurs, i ka arritur pikët maksimale vlerësuese, dhe për të njëjtin është lëshuar akt emërimit, nuk e legjitimon procedurën e përzgjedhjes së të njëjtit në këtë pozitë, për shkak se, janë shkelur dispozitat e procedurës administrative, të cilat kanë pasur ndikim në përzgjedhjen e tij si kandidatë fitues. Gjykata thekson se bazuar në nenin 7.1 të LPK-së është paraparë se "Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla", andaj në kuptim të kësaj, në rastin konkret, paditësi ka dështuar që të paraqet faktet dhe provat, për të argumentuar në këtë procedurë gjyqësore bazueshmerinë e kërkesëpadisë. Mbi të mësipërmen, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e padisë nuk i aprovoj, sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit administrativ. Gjykata ka vendosur si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi duke lënë në fuqi vendimin e kësaj gjykate A.nr.1003/2021 i datës 18.06.2021 për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit A.nr.224/2021 i datës 20.04.202 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, në përputhje me dispozitën e nenit 309.2 të LPK-së ku parashihet se "Po që se nuk aprovohet kërkesëpadia me aktgjykimin e shkallës së parë, gjykata kompetente mund ta lejë në fuqi masën e sigurimit deri sa aktgjykimi i shkallës së parë të mos behët i formës së prerë", pasi që gjykata vlerëson se është e nevojshme edhe më tutje që të mbetet në fuqi vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative".

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata

e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitës së nenit 16 par.1 të LKA-së lidhur me nenin 182 paragrafi 2 pika n), sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, këto pretendime janë të pabazuara për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, në aktgjykim janë dhënë arsyet për faktet vendimtare, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Po ashtu sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të vendimit Gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Sa i përket pretendimit ankimor për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike se *“...aktgjykimi i ankimuar përmbanë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pas që gjykata në mënyrë të gabuar ka përfunduar shqyrtimin e kësaj çështje duke mos u lëshuar fare në provat e bashkangjitura padisë...”*, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit edhe ky pretendim nuk qëndron, kjo për faktin se bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka nxjerrë përfundim kur ka konstatuar se *“Gjykata e vlerëson si të drejt qëndrimin juridik të organit të paditur të paraqitur në vendimin e kontestuar sipas të cilit rezulton se KZKA i Komunës së Klinës me rastin e nxjerrjes së vendimit 02 nr.112-8046/2018 të datës 21.12.2018, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregulloren nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike dhe se meqenëse është konstatuar se pretendimi i ankuesit se procedura e rekrutimit për pozitën e shpallur në konkursin e datës 28.09.2018 është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 par.1, është i bazuar, pasi që kandidatja L.G e cila është përfshirë në listën e shkurt nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, përderisa nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka aprovuar ankesën e ankuesit H.B ndërsa ka anuluar procedurën e rekrutimit për konkursin e lartcekur. Në këtë drejtim gjykata thekson se me dispozitën e nenit 29 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil shprehimisht është përcaktuar se “1. KPSHC duhet të përgatisë një listë të shkurtë prej së paku prej tre kandidatëve. Nëse paneli nuk mund të identifikoj së paku tre kandidatë adekuatë për përfshirjen në listën e shkurtër, pozita duhet të ri shpallet. 2. Pas ri shpalljes së pozitës, KPSHC bën përzgjedhjen edhe nëse ka më pak se tre kandidatë për listë të shkurtë”. Prandaj nisur nga ky përcaktim ligjor dhe fakti që kandidatja L.G e cila kishte aplikuar në konkurs dhe ishte përzgjedhur në listën e shkurtë së bashku me paditësin dhe kandidatin H.B, është konstatuar që e njëjta nuk e kishte përvojën e punës prej 2 viteve të kërkuar me konkurs, pasi që e ajo kishte diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës me datë 02.12.2016, ndërsa sipas akt emërimit të datës 01.02.2017 ka qenë e angazhuar si praktikante vullnetare në Gjykatën Themelore në Pejë, kurse e njëjta ka aplikuar në konkursin e datës 28.09.2018, e që i bie se ka pasur 1 vit përvojë pune pas diplomimit, gjykata vlerëson se janë shkelur dispozitat e procedurës administrative, përkatësisht ato nga neni 28 dhe 29 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me rastin e përzgjedhjes së këtu paditësit për vendin e punës Sekretar në SHFMU “Ali Krasniqi” dhe me plotësim norme në Shkollën e Qabiqit. Kjo për shkak se, bazuar në dispozitën e nenit 29.1 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, KPSHC fillimisht është dashur të përgatisë listën e ngushtë prej tre kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pozitën e shpallur që ti nënshtrohen procedurës së testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, kurse në rastin konkret kur Komisioni Përzgjedhës i Komunës së Klinës e ka përgatitur këtë listë, duke e*

bërë pjesë të listës edhe kandidaten L.G e cila nuk e ka pasur përvojën e punës të kërkuar me konkurs, ka bërë shkelje të kësaj dispozite kur e ka zhvilluar deri në fund procedurën e rekrutimit duke rekomanduar si kandidatë fitues paditësin, pasi që pa kandidaten L.G e cila nuk i ka plotësuar kriteret me konkurs, konkursi do të duhej të anulohet dhe të ri shpallej konkurs i ri, sepse për pozitën e lartcekur si kandidatë në listën e ngushtë do të ishin vetëm paditësi dhe kandidati tjetër H.B, e nëse tek pas ri shpalljes së konkursit nuk do të kishte tre kandidatë, atëherë përzgjedhja e tyre në listën e ngushtë do të mund të bëhej në vështrim gjithnjë të nenit 29.2 të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil edhe nëse kishte për të pasur më pak se tre kandidatë”.

Në këtë kuptim kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë nga shkresat e lëndës me të drejtë ka gjetur se i padituri me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar ka vlerësuar drejtë shkresat e lëndës në mbështetje me provat e prezantuara dhe në përputhje me gjendjen faktike. Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore pasi që paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij ankimore, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu aktgjykimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Prandaj, kolegji i apelit vlerëson se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të paditësit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadsisë së paditësit, mbi këto arsye ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.83/2025, datë 03.03.2025

Kryetar i kolegjit
Hajriz Hoti